



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION



## **MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**

**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS**

**DHE**

**QENDRA PËR NDIHME JURIDIKE DHE ZHVILLIM REGJIONAL**

### **Deklaratë e përbashkët**

Duke pasur parasysh se:

- Oda e Avokatëve të Kosovës (në tekstin e mëtejmi OAK) mban përgjegjësinë kryesore për ngritjen e standardeve të sjelljes etike te anëtarëve të saj avokatë, dhe për kryerjen e hetimeve disiplinore dhe seancave administrative si dhe nxjerrjen e vendimeve disiplinore për këtë qëllim,
- raportimi i kërkesës së bazuar për hetime rreth sjelljes jo etike ose joprofessionale të anëtarëve të OAK duhet të rishikohet dhe të hetohet nga OAK në mënyrë që të reduktohen rastet e sjelljes së pahijshme të avokatëve, të adresohet dhe të parandalohet dëmi ndaj klientëve dhe publikut, dhe të ruhet reputacioni i profesionit ligjor,
- 6 zyrat rajonale të OAK të cilat kanë mbështetur publikun në kompletimin dhe mbledhjen e kërkesave disiplinore të OAK për hetime, më nuk do të janë të hapura (funksionale), meqenëse OAK ruan burimet e saj për të zgjeruar kapacitetin e hetimeve disiplinore përmes krijimit të Zyrës së saj të Prokurorit Disiplinor,
- Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regional (më tutje QNZHR) është profesionalisht dhe gjeografikisht mirë e pozicionuar për t'i ofruar publikut mbështetje profesionale në kompletimin dhe paraqitjen e Kërkesës për Hetim të OAK,

Prandaj ne jemi të bindur se me një udhëzim aktiv dhe mbështetje të Komisionit Disiplinor të OAK dhe QNZHR posedojnë përvojën e duhur profesionale dhe shkathtësítë e nevojshme për zbatimin e përgjegjësive që dalin nga ky Memorandum Mirëkuptimi.

## **Neni I**

### **Objektivi**

Ky Memorandum Mirëkuptimi (MM) përcakton bashkëpunimin në mes OAK dhe QNZHR në ndërmarrjen e përpjekjeve të përbashkëta, në përputhje me mandatet e tyre përkatëse apo misionet, për të përmirësuar qasjen e publikut në sistemin disiplinor të OAK, dhe për të përmirësuar cilësinë e Kërkeseve për Hetime të pranuara nga OAK, nga ana e publikut.

## **Neni II**

### **Palët në memorandum**

1. Palët në këtë marrëveshje janë ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS (më tutje OAK), dhe QENDRA PËR NDIHMË JURIDIKE DHE ZHVILLIM REGJIONAL (më tutje QNZHR)
2. OAK dhe QNZHR bien dakord të bashkëpunojnë për të përbashkëtë reciproke, duke e ruajtur identitetin e tyre.

## **Neni III**

### **Vlerat e bashkëpunimit**

Palët do të:

- a) Veprojnë në kuadër të mandatit të tyre
- b) Promovimi i tolerancës dhe mirëkuptimit
- c) Bashkëpunojnë në përcaktimin e veprimeve për arritjen e qëllimit të këtij memorandumi

## **Neni IV**

### **Përgjegjësitë e palëve**

#### **1. Përgjegjësitë e OAK**

- a) Të koordinojë punën dhe bashkëpunimin ndërmjet palëve në këtë marrëveshje. Kjo do të arrihet përmes Zyrës së Prokurorit Disiplinor të OAK (ZPD).
- b) Ofrimi dhe organizimi i trajnimeve për zyrtarët e dhe QNZHR në temat:
  - a. Ligji për avokatinë,
  - b. Kodi i Etikës Profesionale të Avokatëve dhe,
  - c. Rregullorja e Kosovës për Procedurën Disiplinore.
- c) Zyrtarët e QNZHR duhet bërë përpjekje për të marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga OAK-ZPD në këto tema: Ligji për Avokatinë, Kodi i Etikës Profesionale të Avokatit dhe Rregullorja mbi Procedurën Disiplinore.

- d) Certifikimi i zyrtarëve të QNZJHR pas ndjekjen e trajnimeve të lartë përmendura.
- e) Këshillojë të gjitha palët të cilat kërkojnë ndihmë në plotësimin e formularit të OAK “Kërkesë për Hetime” për tu adresuar në QNZJHR për këtë qëllim.
- f) Informojë me shkrim, të gjitha institucionet relevante për këtë MM dhe qëllimet e tij, duke përfshirë të gjitha gjykatat dhe prokuroritë në Kosovë, si dhe Ombudspersonin e Kosovës;
- g) Realizimi i një fushate të informimit publik për informim rreth përbajtjes relevante të këtij MM.
- h) Të sigurojë QNZJHR me një furnizim të të gjithë formularëve relevant të OAK dhe materialeve udhëzuese për shpërndarje në të gjitha zyrat e tyre përkatëse në terren në Kosovë.
- i) Pranojë të gjitha Kërkesat për hetime të cilat QNZJHR pranon nga qytetarët. Në të gjitha rastet kur ZPD informohet se QNZJHR ka mbështetur parashtresën e Ankuesit të Kërkesës për Hetime, ZPD do të njoftojë QNZJHR nëse ZPD ka filluar hetimet apo jo.

## **2. Përgjegjësitë e QNZJHR**

1. Të sigurojë për të gjithë personat të cilët paraqiten në Zyrën Regionale dhe kryesore (HQ) të QNZJHR Formularin e Kërkesës për Hetim dhe materiale tjera udhëzuese të ofruara nga OAK.
2. Pranojë, regjistrojë dhe dorëzojë në OAK-ZPD të gjithë Formularët e Kërkesës për Hetime të cilët arrijnë në zyre regionale dhe atë qendrore (HQ) të QNZJHR.
3. Në rast se QNZJHR konsideron ankesën e klientit si të pabazuar ose të gabuar, duhet të këshillojë palën rreth mjeteve të tjera ligjore që mund të jenë në dispozicion, të regjistrojë rastin, dhe njoftojë zyrën disiplinore të OAK për veprimin që është ndërmarrë.
4. Në rast se QNZJHR gjen se është e vlefshme ankesa, duhet të ndihmojë palën për të plotësuar Formularin e Kërkesës për Hetim kundër avokatit/praktikantit.
5. Zyrtarët e QNZJHR duhet bërë përpjekje të marrin pjesë në trajnimet e organizuara nga OAK në këto tema: Ligji për Avokatinë, Kodi i Etikës Profesionale të Avokatit dhe Rregullorja për Procedurën Disiplinore.

**Neni V**  
**Detyrimet financiare**


Ky MM nuk do të interpretohet si krijim i ndonjë detyrimi finanziar midis dhe ndërmjet palëve

**Neni VI**  
**Modifikimi i marrëveshjes**


Çdo ndryshim i këtij memorandumi mund të bëhet me marrëveshje reciproke.

**Neni VII**  
**Nënshkrimet**

Kjo marrëveshje është përgatitur në frysën e besimit dhe bashkëpunimit mes të gjitha palëve.



Ibrahim Z. Dobruna,  
Kryetar i OAK



Nedžad Radončić,  
Drejtorekzekutiv, QNJZHR